FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION
VENDIMET NGA MBLEDHJA E BORDIT TË FGJK-SË

Bordi Ekzekutiv (BE) i FGJK-së, me datë 19 Mars 2026 duke filluar nga ora 16:00, mbajti mbledhjen e bordit në zyrën e FGJK-së, në Shtëpinë e Sportit në Prishtinë, duke ju përmbajtur rëndit të ditës.

REND I DITËS

1. **Hapja e mbledhjes nga Kryetari:** Mbledhja është hapur nga Kryetari i FGJK-së, Z. Shkumbin Maqastena, i cili falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje në këtë mbledhje.
2. **Caktimi i një proces-mbajtësi:** Kryetari Z. Maqastena propozoj që procesmbajtës në këtë mbledhje të jetë Sekretari i Përgjithshëm, Z. Amir Tahiraga, të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenim.
3. **Veriëikimi i pjesëmarrsëve në mbledhje, numri i tyre:** Në këtë pikë të rendit të ditës, u vërtetua se prezent në mbledhje ishin 7 anëtarë me të drejtë vote, gjithashtu prezent ishin edhe Sekretari i Përgjithshëm, dhe Sekretari Teknik pa të drejtë vote e që në total 9 anëtarë të pranishëm.

   Të pranishëm në mbledhjë të BE të FGJK-së, ishin:

   1. Shkumbin Maqastena – Kryetar i FGJK -së,
   2. Sheriëe Aliçkaj Qerimi – Nënkryetare e FGJK -së,
   3. Besim Halilaj – Nënkryetar i FGJK -së
   4. Elëete Gashi – Anëtare e BE të FGJK -së,
   5. Lisa Zeqiri – Anëtare e BE të FGJK -së,
   6. Besnik Latiëi – Anëtar i BE të FGJK -së.
   7. Rizonë Mustaëa – Anëtare e BE të FGJK-së,
   8. Amir Tahiraga – Sekretar i Përgjithshëm i FGJK-së, pa të drejtë vote.
   9. Arlind Shaqiri – Sekretar Teknik i FGJK-së pa të drejtë vote.
4. **Organizimi i garës së Nivelit C në Gjimanstikë Artistike për Femra dhe Meshkuj**: Në këtë pikë të rëndit të ditës u Kryetari i FGJK-së, Z. Maqastena njoëtoj të pranishmit rreth organizimit të të garës së nivelit C, dhe se për shkak të angazhimit të madh të gjimnastëve, dhe mundësisë së masovizimit të këtij sporti dhe dhënjes së mundësisë që gjimnastet/tët e rinj të garojnë dhe të fitojnë eksperience është vendosur që në këtë nivelit C të futet ose ndahet në dy kategori në C1 dhe C2. Në C1 parashihet që të garojnë gjimnastet me përgatitije me të lartë dhe me ushtrime më të vështira, kurse C2 gjimnasët fillestar me elemente më të thjeshta dhe bazike. Të gjithë të pranishmit votuan pro nuk kishte abstenime apo kundër.

   Data dhe vendi i mbajtjes së garës: Pas shumë diskutimeve dhe dhënjes së shume mendimeve dhe datave, është vendosur që gara të mbahet me 26 Prill 2026 në hapësirat e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit në Prishtinë, dhe se gara të ndahet në dy termine nga ora 09:00 deri në ora 13:00 të garojne C2, kurse nga ora 14:00 të vazhdohet me C 1 deri në përfundim të garës. Të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenim. Poashtu

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

është vendosur që të gjithë pjesëmarrësit të marrin medalje për vendet e 1,2,3 dhe për pjesëmarrje në këtë garë. Të gjithë të pranishmit votuan pro nuk kishtë kundër apo abstenime.

Në këtë garë është vendosur që të kemi gjyqtar të rinjë së bashku me gjyqtar me përvoj dhe se do të ndahen nëpër disiplina, dhe se garuesit do të shkojnë me rrotacion. Të gjithe votuan pro, nuk kishte abstenim apo kundër. Është propozuar që të gjithë të pjesëmarrësit në organizimin e kësaj gare të marrin meditje për aq dite sa punojnë me një, pas shume diskutimeve të gjithë anëtarët votuan pro, nuk kishte abstenime apo kundër. Komisioni garues të përgatit planin operativ për këtë garë, dhe Sekretari i Përgjighshëm i FGJK-së, të përgatit vendim për të gjithë pjesëmarrësit që marrin pjesë në organizimin e kësaj gare.

5. **Organizimi i Kampit në Kroaci për gjimnastikë artistike për femra:** Sekretari i Përgjithshëm i FGJK-së, njoftoj të pranishmit se FGJK pas kontaktit me përfaqësuesit e Federatës së Gjimnastikës Kroate për organizimin e Kampit Stërvitor në Kroaci, dhe se bazuar në kërkesat e gjimnasteve dhe trajnërve, kampi të organizohet në Nedelisce të Kroacisë, ku edhe është arrit marrveshje që ky kamp të mbahet nga data 06 deri me 12 Prill 2026. Në këtë kamp stërvitor gjimnastet do të përzgjidhen bazu nga rezultatet e vitit 2025, dhe pas shumë diskutimeve është arrit që të ceket edhe numri i pjesëmarrsëve në këtë kamp, ku totali i gjimnasteve do të jetë 10, dhe 4 trajnerë. Sekretari i përgjithshëm njoftoj të pranishmit se është në kontakt me agjencion për të rezervuar transportin, dhe të gjitha detajet tjera në lidhje me organizimin e këtij kampi. Të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenime.
6. **Gara e Nivelit B,** Në këtë pikë të rendit të ditës, Kryetari Maqastena njottoj që kjo garë të mbahet më vonë, dhe pas shumë diskutimeve është vendosur që gara të mbahet me datë 16 Maj 2026, duke filluar nga ora 09:00. Gara do të mbahet në sallën e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sporteve, pas diskutimeve të gjithë të pranishmit votuan pro, nuk kishte kundër apo abstenime, ku edhe u tha që të fillohet edhe të punohet për këtë garë, Komisioni garues të përgatit planin operativ për këtë garë, dhe Sekretari i Përgjighshëm i FGJK-së, të përgatit vendim për të gjithë pjesëmarrësit që marrin pjesë në organizimin e kësaj gare.
7. **Të ndryshme:** Në këtë pikë të rendit të ditës Sekretari i Përgjithshëm, njoëtoj të pranishmit për komunikimin ndërmjet FGJK-së, dhe Kompanisë Spieth, të cilët janë në proces të dërgimit të veglave gjimnastikore, të cilat janë donacion nga Gjimnastka Europiane, dhe se shumë shpejt veglat do të arrijnë në Kosovë.

Mbledhja e BE të FGJK-së përëundoi me datë 19/03/2026 prundoj në ora 17;30.

Amir Tahiraga: _____
Sekretar i Pëgjithshëm i FGJK-së

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com